


FINANCA & EKONOMIA

Ditari Mujor | Qershor 2023

Performanca Paraprake 5 – Mujore e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat totale për 5-mujorin e vitit 2023 u realizuan në masën 102% të planit të të njëjtës periudhë. Shpenzimet e përgjithshme publike, për 5 – mujorin e vitit 2023, arritën në rreth 221.7 miliard LEK me një realizim në 90 përqind të planit të të njëjtës periudhë. Krahasuar me vitin 2022 shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë +3.5 përqind më të larta ose rreth +7.6 miliard LEK më shumë. Niveli i suficitit për periudhën 5 – mujore të vitit 2023 rezultoi në rreth 36.2 miliard LEK nga rreth 7 miliard lekë suficitit i planifikuar.

▶ LEXO MË SHUMË



Takim konsultativ në UB për reformën e taksës së pasurisë

Ministria Ibrahimaj zhvilloi një takim konsultativ me pedagogë dhe studentë të Universitetit Bujqësor lidhur me reformën e Taksës së Pasurisë, me qëllim informimin dhe diskutimin mbi këtë reformë, për të cilën MFE po harton një projektligj. Ministria tha se përmes p/ligjit synohet të rritet efica e përdorimit të tokës, të nxiten incentivat për shfrytëzimin e saj dhe të përmirësohet forma e taksimit të pronës. Nga ana tjetër, Ministria theksoi faktin se taksa duhet të jetë e drejtë, efektive, transparente dhe mbi të gjitha e thjeshtë.

▶ LEXO MË SHUMË

Takimet me misionin e FMN, diskutohen zhvillimet makroekonomike

Një ekip i FMN, i kryesuar nga Znj. Anke Weber, zhvilloi një vizitë në Shqipëri gjatë datave 13-19 qershor, ku pati disa takime me drejtues të MFE. Në këto takime, palët analizuan dhe vlerësuan zhvillimet aktuale të ekonomisë shqiptare, me tema kryesore diskutimi: Politikë fiskale dhe buxhetore; Performanca e të Ardhurave dhe prespektiva e tyre; Ecuria e shpenzimeve buxhetore; Masat për reduktimin e borxhit publik dhe trajtimi i rreziqeve fiskale; Pensionet, demografia dhe tregu i punës. Në përfundim të misionit, FMN vlerësoi se ekonomia e Shqipërisë ka shfaqur qëndrueshmëri përballë goditjeve të njëpasnjëshme dhe shprehu mbështetjen për angazhimin e autoriteteve për konsolidim fiskal.



MONEYVAL: Shqipëria ka përmirësuar masat në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Shqipëria ka përmirësuar masat e saj për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Ky është përfundimi i MONEYVAL, sipas raportit të së cilit, Shqipëria ka përmirësuar përfundimisht e saj me Rekomandimet 25 të Task Forcës së Veprimit Financiar, që lidhen me transparencën dhe pronësinë përfituese të marrëveshjeve ligjore, si dhe 28, që lidhen me rregullimin dhe mbikëqyrjen e bizneseve dhe profesioneve të përcaktuara jofinanciare. Sipas vlerësimit në MONEYVAL, në përgjithësi, Shqipëria ka bërë përparim në adresimin e shumicës së mangësive të përputhshmërisë teknike të identifikuara në Raportin e saj të Vlerësimit të Ndërsjelltë 2018.

▶ LEXO MË SHUMË



Ibrahimaj në Forumin e BB për menaxhimin dhe transparencën e borxhit

Ministria Ibrahimaj mori pjesë në forumin e Bankës Botërore, "Forcimi i legjislacionit të menaxhimit të borxhit sovran për të rritur transparencën", i cili u organizua në Berlin, 15-16 qershor 2023. Në fjalën e saj, Ministria Ibrahimaj u shpreh se qeveria shqiptare mbetet e angazhuar në menaxhimin e kujdesshëm dhe uljen e borxhit publik të vendit, duke theksuar se në projeksionet afatmesme dhe afatgjata parashikohet një rënie e mëtejshme e nivelit të borxhit, ndërsa planifikohet të arrijë nën 60% të Produktit të Brendshëm Bruto brenda vitit 2030.

▶ LEXO MË SHUMË



Forcimi i bashkëpunimit mes MFE dhe BERZH

Ministria Ibrahimaj priti në një takim zyrtar Bordin e drejtorëve të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Diskutimet u fokusuan mbi bashkëpunimin dhe mbështetjen e mundshme që BERZH-i mund të japë për MFE lidhur me ecurinë e reformave strukturore në vendin tonë, veçanërisht sa i përket angazhimit për negociatat me BE, për kapitujt që lidhen me zhvillimin ekonomik, konkurrencën dhe klimën e investimeve. Ibrahimaj bëri një prezantim të shkurtër të situatës makroekonomike, reformave e politikave të ndërmarra nga qeveria për përballimin e krizave, të cilat ndikuan në performancën e ekonomisë shqiptare.

▶ LEXO MË SHUMË

Masat e ndërmarra nga qeveria zbutën ndikimet negative të krizave

Ministria Ibrahimaj mori pjesë në konferencën e FMN "Politikëbërja në "ujëra të turbullta": Nxitja e Elasticitetit në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE)". Në fjalën e saj, Ministria foli për rolin e politikës fiskale sa i përket sfidës së uljes së nivelit të inflacionit dhe stabilizimit të ekonomisë përballë goditjeve të ofertes. Ministria u shpreh se masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare gjatë vitit të kaluar ndikuan ecurinë ekonomike të vendit dhe në nivelin e inflacionit, si mbështetja e shtresave në nevojë, duke bërë disa prioritete të shpenzimeve dhe duke krijuar hapësirë e nevojshme fiskale për këtë.

▶ LEXO MË SHUMË



NISMAT LIGJORE TË MFE:



Miratohen ndryshimet në ligjin "Për strehimin social"

Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin "Për strehimin social", të cilat synojnë përmirësimin e politikave të strehimit social, zgjerimin e kategorive dhe rritjen e numrit të përfituesve.

▶ LEXO MË SHUMË

Ndryshon ligji "Për nxitjen e Punësimit", synim punësimi i të rinjve dhe PAK

Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin "Për nxitjen e punësimit", të cilat synojnë adresimin e disa sfidave lidhur me punësimin e të rinjve, personat me aftësi të kufizuara apo grupe të tjera të veçanta.

▶ LEXO MË SHUMË

Forcimi i miradministrimit të financave vendore

Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të cilat synojnë të forcojnë miradministrimin e financave të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ulin stokun e detyrimeve të prapambetura.

▶ LEXO MË SHUMË

Mbrojtja e prodhimit vendas dhe ruajtja e sigurisë ushqimore

Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin "Për taksat kombëtare". Nisma ka synim mbrojtjen e prodhimit vendas dhe ruajtjen e sigurisë ushqimore, pasi parashikohet heqja e taksën për produktin hurrë qumështi dhe taksën për krem qumështi për eksportuesit dhe për prodhuesit vendas.

▶ LEXO MË SHUMË